

Z. Endri Bushati ka lindur në Tiranë, në vitin 1982. Z.Bushati ka një karrierë profesionale të pasur në fushën e ekonomisë dhe menaxhimit me më shumë se 10 vjet përvojë pune.

Z. Bushati është diplomuar për Ekonomi në vitin 2007 në Universitetin e Indianapolis të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (kampusi i Athinës). Më pas, ai përfundoi studimet për Master Shkencor në universitetin e “King’s College London” së Mbretërisë së Bashkuar për Politika dhe Menaxhim të Shërbimeve Publike.

Përgjatë periudhës 2009-2012 ka punuar në Bashkinë e Tiranës me fokus kryesor fushën e menaxhimit/koordinimit të projekteve. Duke vazhduar prej vitit 2012 e deri më sot, Z.Bushati mban detyrën e Konsulentit/Ekspertit të Menaxhimit Financiar dhe Zhvillimit Ekonomik në organizata dhe kompani të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe është përfshirë dhe ka përfituar ekspertizë të thelluar në zhvillimin e planeve strategjike, planeve të biznesit dhe modeleve financiare, trajnimin dhe këshillimin e Këshillave (bordeve) të Administrimit të ndërmarrjeve/institucioneve. Gjithashtu, paralelisht përgjatë periudhës 2014-2019 ka mbajtur detyrën e pedagogut në zhvillimin e lëndës së menaxhimit të projektit.

Përgjatë periudhës 2017 dhe aktualisht Z.Bushati mban detyrën e Kryetarit të Bordit të shoqatës sportive “Program of Special Olympics Albania” e cila ka si objektiv fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara intelektuale nëpërmjet organizimin e aktiviteteve sportive. Z.Bushati është përfshirë vullnetarisht në këtë detyrë pasi beson se *sporti thyen barrierat brenda dhe jashtë fushës së lojës.*